# DËSHMI ARKIVI

**A-428761**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Territorialja dhe Zgjedhorja prioritetet e PS-së”, Taulant Balla: Projektligji për pagat e magjistratëve kalon për miratim më 17 shtator – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/territorialja-dhe-zgjedhorja-prioritetet-e-ps-se-taulant-balla-projektligji-per-pagat-e-magjistrateve-miratohet-me-17-shtator/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 16:53:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 10:42:04 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cd282c71bf377c0453c94fe7dd0e4a3b3b9ef7e4b784de73f7349aff5206ebea` |
| TEKSTI | `eb0fe10723d7bfd1d862a50c21e1d1e0650709f358f0cdf3aaf1bd0c6fc56885` |
| PAMJA | `4c22aa8d2f506a2ab9311c93c3a4e0e130b21915605b4126b244c988125da813` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a6461df01c2ee542f7ba18ffb76315c6f3b7355844890ca9176cf16abcaa9b86` |
| E MËPARSHMJA | `efae8f546928e8e2713421905e2f56130b30d75660d6b4b03d7f27967b90f728` |
| RRËNJA MERKLE | `7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a6461df01c2ee542f7ba18ffb76315c6f3b7355844890ca9176cf16abcaa9b86`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, deklaroi se projektligji që adreson vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pagat e magjistratëve do të shqyrtohet dhe pritet të miratohet në Kuvend më 17 shtator.

Pas mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, Balla tha se projektligji është depozituar nga dy deputetë të Partisë Socialiste dhe është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese.

“Në Kuvend ka 140 deputetë, por vetëm 2 deputetë të PS-së kanë dorëzuar një projektligj që adreson vendimin e Kushtetueses. Kështu po e ushtrojmë përgjegjësinë që na takon”, u shpreh Balla.

Ai theksoi se nisma do të shqyrtohet me prioritet, por jo me procedurë të përshpejtuar.

“Projektligji është depozituar brenda afatit të caktuar nga Kushtetuesja dhe do të shqyrtohet me prioritet. Është një projektligj që nuk shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar”, tha ai.

Duke komentuar debatet rreth pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Balla mbrojti kompetencën e Kuvendit për përcaktimin e pagave, duke iu referuar parimit të ndarjes së pushteteve.

“Si qytetar mendoj se, në një shtet demokratik, me ndarje të pushteteve, kompetenca për caktimin e pagave është vetëm e Kuvendit. Prisni të flasë Kuvendi”, deklaroi kreu i Grupit Parlamentar të PS-së.

Balla foli gjithashtu për prioritetet e mazhorancës në sesionin e ri

5 Elbasani nuk fal! Egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Balla foli gjithashtu për prioritetet e mazhorancës në sesionin e ri parlamentar, duke veçuar reformën territoriale dhe reformën zgjedhore.

“Themeli i punës për këtë shumicë është miratimi i reformës territoriale dhe miratimi i një reforme zgjedhore që të adresojë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, për të garantuar në kohë marrjen e masave për zgjedhjet vendore të 2027-s”, tha Balla.

Sipas tij, një tjetër element i rëndësishëm është komunikimi i deputetëve me qytetarët dhe adresimi i problematikave të tyre përmes kanaleve zyrtare.

“Është shumë e rëndësishme që deputeti, çdo problematikë, çdo hall të qytetarëve ta adresojë përmes kanaleve që i përcaktohen zyrtarisht”, u shpreh ai.

Balla deklaroi se mazhoranca synon një mënyrë të re komunikimi me qytetarët gjatë mandatit të katërt të saj, duke iu referuar edhe nismës “Prania Besnike”.

“Në këtë mandat të katërt kemi një kthesë historike për komunikimin me qytetarët”, tha Balla.

#Reformaterritoriale #TaulantBalla

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor:...**

Xhuljana Zhuleku · 49 minuta më parë




POLITIKË

**“Nuk po na lejohet të marrim nga qesja...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 21:49



POLITIKË

**“Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 20:03

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.